
PËRFITIMET E PUNËTORËVE NGA PAKOJA EMERGJENTE

PRISHTINË – 30 PRILL 2020



PËRFITIMET E PUNËTORËVE NGA PAKOJA EMERGJENTE

PRISHTINË – 30 PRILL 2020

COPYRIGHT © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Autor: **Florent Spahija** *Këshilltar Ligjor*



Pakoja fiskale emergjente e qeverisë dhe masat për punëtorët pa kontrata

Shpallja e pandemisë botërore për shkak të virusit Covid-19 ka prekur edhe Kosovën, duke ndaluar funksionimin e rregullt të shumë sektorëve shoqëror, e veçanërisht atij ekonomik. Biznesi privat pothuajse është paralizuar për shkak të vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në funksion të mbrojtjes së popullatës nga përhapja e virusit. Si rezultat i këtyre masave, pandemia ka prekur të hyrat e shumë bizneseve private, një sektor shumë i ndjeshëm dhe fragjil i cili varet pothuajse në tërësi nga blerjet e brendshme e shumë pak nga eksporti.

Eksporti i mallrave në muajin shkurt 2020 kishte vlerën 35.9 milionë euro, ndërsa importi 263.3 milionë euro [...].¹ Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, sektorët ekonomikë, që prijnë me punësim, vazhdojnë të jenë: tregtia me 16.0%; ndërtimtaria me 11.8%; prodhimi me 11.7%; si dhe arsimit me 10.2%. Ndërsa, sektorët e tjerë marrin pjesë me përqindje më të vogël në punësim.² Vjetari i ASK-së për Kosovën zyrtarisht tregon se gjatë vitit 2018 kanë qenë të punësuar 345131 persona në të dy sektorët, ndërsa papunësia për popullsinë aktive arriti në 144972 persona. Numri i të punësuarve në sektorin publik ishte 81884 persona, ndërsa për sektorin privat nuk ka një shifër të saktë zyrtare.³

Në ditën kur në Kosovë u paraqiten rastet e para të të infektuarve me COVID-19, Qeveria përmes një vendimi⁴ ndaloi veprimtaritë e disa bizneseve siç janë kafenetë, pabët, baret, restorantet, qendrat tregtare, tregjet e hapura të kafshëve dhe automjeteve, me arsyen e vetme shmangien e përhapjes së virusit tek qytetarët. Madje me vendime të Qeverisë u ndaluan qarkullimi i qytetarëve në komuna ku pati të prekur, për të parandaluar përhapjen e virusit nëpër komunat e tjera.

Me datën 15 mars 2020 Qeveria shpalli gjendjen e Emergjencës për shëndetin publik dhe menaxhimin e situatës së emergjencës ia kaloi Ministrisë së Shëndetësisë.⁵ Disa ditë më vonë kufizoi Qeveria lirinë e lëvizjes së qytetarëve në orë të caktuara⁶, përjashtim nga ky kufizim patën bizneset për qarkullim të lirë të mallrave dhe shërbimeve sipas kodeve të përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë, Punësimi, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike. Por, kjo masë kufizuese vazhdoi ndikimin tek bizneset që punojnë edhe në kohë të pandemisë, pasi që kufizimi i lirisë së lëvizjes së qytetarëve në kohë të caktuara, pothuajse paralizoi komplet këto biznese.⁷

1 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Tregtisë së Jashtme, shkurt 2020 e datës 23.03.2020, i qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-shkurt-2020>, qasur nga KDI me datë 22.04.2020

2 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketat e fuqisë punëtore TM4 2019 e datës 19.03.2020 i qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/anкета-e-fuqise-punetore-afp-tm4-2019>, qasur nga KDI me datë 22.04.2020.

3 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2019, faqe 14 dhe 15, i qasshëm në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/vjetari-statistikor-i-republikes-se-kosoves-2019>, qasur nga KDI me datën 22.04.2020

4 Vendimi numër 01/09 i datës 13.03.2020 <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Scan-14-Mar-2020.pdf>

5 Vendimi numër 01/11 i datës 15.03.2020 <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-nr01-11.pdf>

6 Vendimi numër 01/15 i datës 23.03.2020 <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-15-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf>

7 Kundër këtij vendimi qeveritar doli Presidenti i Republikës së Kosovës duke e dërguar atë në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë, me arsyetimin se kufizimi i lirisë së lëvizjes nuk mund të bëhet me një vendim qeveritar dhe si i tillë është në kundërshtim me Kushtetutën [Me datën 24.03.2020, Presidenti i Kosovës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese <https://telegrafi.com/thaci-e-dergon-ne-kushtetuese-vendimin-e-qeverise-per-kufizim-te-levizjes-se-qytetareve/>] Gjykata Kushtetuese tutje merr aktgjykim me të cilin shpalli që vendimi 01/15 i Qeverisë nuk është në përputhje me Kushtetutën, dhe konstatoi që vetëm Kuvendi mundet përmes një Ligji të kufizoi të drejtat dhe lirit themelore. [Aktgjykimi me numër të rastit KO54/20 i datës 06.04.2020 https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/04/ko_54_20_agj_shq.pdf]





Duke e parë situatën e rënduar, organizatat e shoqërisë civile dhe odat ekonomike në Kosovë reagojnë duke kërkuar një plan emergjent të shpëtimit të biznesit nga Qeveria⁸. Me datën 30.03.2020 Qeveria aprovoi pakon emergjente⁹ të përbërë nga 15 masa dhe në vlerë prej 170 milionë eurosh për tejkalim të krizës që përfshinte të dy sektorët, atë publik dhe atë privat.

Qeveria e Kosovës përkatësisht Ministria e Financave dhe Transfereve, në pakon emergjente¹⁰ tek pjesa e bizneseve ka përfshirë tri kategori të punëtorëve që janë prekur apo dëmtuar nga mbyllja e bizneseve apo nga mungesa e të hyrave për ato biznese.



Kategoritë e punëtorëve për ndihmë sipas pakos qeveritare janë:



Punëtorët e rregullt, të cilët do të mbështeten me

170 €
për dy muaj



Punëtorët e rregullt, të cilët janë larguar nga puna gjatë pandemisë, do të mbështeten me

130 €
për tre muaj



Punëtorët që janë paguar me para të gatshme dhe të cilët biznesi privat do t'i deklarojë si punëtor të ri do të mbështeten me

170 €
për dy muaj pas regjistrimit

⁸ Reagimi i KDI-së, i datës 18.03.2020 i qasshëm në: <http://kdi-kosova.org/aktivitetet/kdi-te-ruhet-stabiliteti-social-dhe-ekonomik-ne-kosove/>
Kërkesa e Odave Ekonomike e datës 27.03.2020 e qasshme në: <https://pek-kcc.org/Al/aktivitete/212/qeveria-te-aloqje-se-paku-300-milione-eurove-per-fazen-emergjente-te-mbeshtetjes-se-sektorit-privat/>, qasur nga KDI me datë 22.04.2020

⁹ Vendimi numër 01/19 i datës 30.03.2020 <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf>

¹⁰ Vendimi numër 01/19 i datës 30.03.2020 <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf>



Pra në një kategori të veçantë janë paraparë edhe punëtorët, të cilët deri në shfaqjen e pandemisë janë paguar me para të gatshme dhe asnjëherë nuk kanë paguar kontribute pensionale apo tatim. Kjo kategori e punëtorëve që kanë punuar pa kontratë pune nuk kanë pas asnjë mundësi t'i shfrytëzojnë të drejtat e saj të punës.

Mirëpo, për përfitimin e kësaj ndihme Qeveria ka paraparë kushte të veçanta, të cilat duhet t'i plotësojnë kompanitë dhe punëtorët nëse dëshirojnë të përfitojnë nga kjo pako.¹¹

Kategoria C apo e punëtorëve që më parë janë paguar me para të gatshme do të ketë mbështetje financiare në lartësinë prej 130 euro në muaj dhe në kohëzgjatje prej dy muajsh gjatë kohës së pandemisë. Sipas Qeverisë kostoja totale e kësaj mbështetje për bizneset do të jetë në lartësi prej 6 milion euro.

[Masa 14 –Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me kontratë pune së paku një (1) vjeçare gjatë periudhës së situatës së emergjencës së shëndetit publik, nga njëqind e tridhjetë (130€) euro për dy muajt pasues pas regjistrimit, në vlerë deri në gjashtë milion (6,000,000.00 €) euro.]

Kushti i parë për përfitim nga pakoja emergjente e Qeverisë është kontrata sëpaku një vjeçare për këta punëtorë. Pra secila kompani duhet të nënshkruaj kontrata të punës sëpaku një vjeçare me punëtorët e tyre, e që këta të fundit të përfitojnë drejtpërdrejt nga pakoja emergjente e Qeverisë. Kjo kontratë duhet të jetë e nënshkruar në kohën kur ka filluar pandemia në Kosovë.

*[Punëdhënësi dhe i punësuar duhet të kenë të lidhur kontratë punësimi për një periudhë jo më të shkurtër se një (1) vit] ...
[Kontrata e punësimit duhet të jetë e nënshkruar pas datës zyrtare të fillimit të pandemisë në Kosovë]*

Kushti tjetër është që punëdhënësi t'i regjistrojë punëtorët në sistemin elektronik në Administratën Tatimore të Kosovës përmes formularëve të veçantë, të ATK-së. 15 Maji 2020 është afati i fundit kur kompanitë mundën t'i regjistrojnë këta punëtorë që të përfitojnë nga ndihma shtetërore.

[Punëdhënësi, përmes sistemit elektronik EDI, duhet të plotësojë dhe ngarkojë formularin dhe listën e dizajnuar nga ATK-ja, më së largu deri më 15 Maj 2020]

Për të përfituar këtë pagesë nga Qeveria, punëtori duhet të ketë një llogari bankare në një nga bankat komerciale. Sipas shpjegimeve nga MFT-ja pagat do të paguhen direkt në llogari të punëtorit dhe nuk do të kalojnë fare nga llogaritë e kompanive. Shteti do të paguaj edhe kontributet pensionale për secilin punëtor.

11 Vendimi numër 01/19 masa 14 i datës 30.03.2020 <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf>



*[I punësuari, duhet të posedojë llogari bankare valide në një nga bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.]
... [Personat të cilët përfitojnë nga kjo masë do të ju paguhen kontributet pensionale në emër të punëdhënësit dhe të punësuarit dhe obligimi tatimor, me qëllim që në fund i punësuari të marrë pagën neto prej 130 euro.]*

[Në rastet kur kontrata shkëputet në mënyrë arbitrare e pa ndonjë arsye valide, punëdhënësi ose punëmarrësi është i obliguar ti kthej këto mjete, varësisht nga vlerësimi i Komisionit.]

Kjo pikë është e favorshme për shumë punëtorë që të fillojnë të përfitojnë nga mundësitë që ofron Ligji i Punës, por ofrimi i kontratave nga kompanitë mbetet në vullnetin e kompanive. Luftimi i informalitetit në kohë pandemie nuk është i duhuri, pasi që ndikon drejtpërdrejt në bizneset, të cilat pas pandemisë, mund të përballen me probleme të mëdha financiare dhe lidhja e kontrata një vjeçare me punëtorë do të ishte një barrë shtesë për ato.

Si masë mbrojtëse për përfituesit nga kjo pikë e ndihmës është paraparë që kompania nuk mund ta shkëpus kontratën një vjeçare pa ndonjë arsye të fortë dhe se shkëputja do të vlerësohet nga vet komisioni shtetëror. Ky rregull siguron punëtorin që së paku ndaj tij me kontratë do të respektohet Ligji i Punës dhe ai/ajo do të gëzojë mbrojtje shtesë nga ana e shtetit. Për bizneset në këtë rast është një lloj humbje, pasi barra për ta bëhet e dyfishtë nëse nuk arrin ta mbajë në punë punëtorin, meqë largimi nga puna i punëtorit do të pasojë edhe me kthimin e mjeteve financiare në arkën e shtetit për secilin punëtor të larguar.

Në anën tjetër nëse punëtorët nuk arrijnë të sigurojnë një kontratë pune një vjeçare, ata kanë edhe një mundësi që të përfitojnë nga pakoja emergjente. Në masën 15-të¹² të kësaj pakoje është paraparë një asistencë për qytetarët që janë në kushte të rënda sociale dhe që nuk përfitojnë asnjë asistencë apo ndihmesë nga shteti. Për të përfituar asistencën në lartësi prej 130 eurosh për tre muaj, punëtorët duhet të paraqiten në entet për punësim për t'u regjistruar si të pa punë.

KDI-ja përmes raporteve "Të drejtat në letër" dhe "Punëtorët që [s'] kanë të drejta"¹³ u ka rekomanduar institucioneve shtetërore që të ulen niveli i informalitetit në sektorin privat dhe konsiderojmë që pakoja e ndihmës ku është përfshirë edhe kategoria e punëtorëve pa kontratë është një mundësi shumë e mirë që shteti ta rregullojë çështjen e informalitetit të punëtorëve, të cilën punojnë dhe paguhen me para të gatshme.

Deri më tani për këta punëtorë nuk janë paguar as kontributet pensionale e as tatimet në pagë. Duke qenë se shteti nuk ka të dhëna mbi numrin e këtyre punëtorëve dhe lartësinë e pagës së tyre, do të jetë e pamundur që kjo kategori të përfitojë nga masat në kuadër të pakos së qeverisë. Për më tepër, kjo shkallë informaliteti e ka vështirësuar edhe më shumë vlerësimin e dëmit ekonomik që ka pësuar sektori privat nga pandemia.

12 Vendimi numër 01/19 masa 15 i datës 30.03.2020 <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf>

13 Raportet e KDI nga viti 2018 dhe 2019 të qasshme në: <http://kdi-kosova.org/publikimet/punetoret-qe-skane-te-drejta/><http://kdi-kosova.org/publikimet/te-drejtat-ne-leter/>



Shkelja e të drejtave të punëtorëve në kohën e pandemisë

KDI-janë gjashtë vitet e fundit ka vazhduar të ofrojë ndihmë juridike falas për të gjithë punëtorët që kanë raportuar që në mënyra të ndryshme kanë pësuar në raport me marrëdhënien e punës. Që nga 1 maji i 2019-ës e deri më 30 prill 2020 janë paraqitur mbi 200 raste të shkeljeve të ndryshme të të drejtave të punëtorëve në të dy sektorët, privat e publik.

Bazuar në raportimet e tyre shqetësuese vazhdon të mbetet numri i madh i punëtorëve që nuk paguhen në kohë, atyre që nuk ju paguhen kontributet pensionale përkundër që parat ju ndalen nga paga, konkurset e manipuluar, orari i zgjatur i punës, largime nga puna pa arsytim dhe pa kompensim adekuat, mosdhënia e pushimit mjekësor e vjetor, etj. Pavarësisht se këto probleme janë përsëritur nga viti në vit dhe pavarësisht se institucionet janë alarmuar për këto probleme në vazhdimësi, kjo praktikë ka ndryshuar shumë pak.

Vetëm me datën 1, 2 dhe 3 Maj 2019, në kuadër të kampanjës së përvitshme të dërgimit të SMS-ve nga operatori Vala për Ditën Ndërkombëtare të Punëtorëve, KDI-ja ka pranuar më shumë se 400 telefonata me raportime nga më të ndryshmet në lidhje me shkeljet e të drejtave të punëtorëve apo me kërkesa për informata se çfarë të drejta duhet t'i gëzojë një punëtor nga puna që bënë. Nga këto telefonata, 150 raste kanë marrë ndihmë juridike të drejtpërdrejt në realizimin e të drejtave të tyre.

Ndërsa nga fillimi i pandemisë KDI-ja ka pranuar 19 raste në të cilat punëtorëve të një mediumi, dy prej të cilëve shtatzëna (gazetar, redaktor, staf tjetër) u janë shkelur të drejtat elementare duke u përjashtuar nga puna pa asnjë paralajmërim dhe në kundërshtim me Ligjin e Punës. KDI-ja secilin rast veç e veç e ka ndihmuar në paraqitjen e ankesave fillimisht tek punëdhënësi. Arsye e shkëputjes në të gjitha rastet ka qenë efekti i pandemisë në biznesin që ka

bërë që disa pjesë të biznesit të mbyllen. Secili nga këta 19 punëtorë ka nënshkruar kontratën e punës në fillim të vitit, disa prej të cilave ishin me afat të pacaktuar.

Pas ankesave të punëtorëve, kompania ka vendosur ndaras për secilin nga punëtorët. Fillimisht në rastin e shtatzënave punëdhënësi ka vendosur që të dyja t'i kthejë në punë ndërsa pjesës tjetër të punëtorëve t'u kompensoj pagat për pjesën që nuk i ka lajmëruar. Me kërkesë të palëve çështja do të dërgohet në Inspektoratin e Punës¹⁴ dhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë për të vërtetuar ligjshmërinë e vendimeve nga ana e punëdhënësit, sidomos në kohë pandemie, kur edhe Qeveria përmes pakos emergjente ka paraparë mundësinë që punëtorët të paguhen nga buxheti i shtetit deri në kalimin e pandemisë.

Në një rast tjetër në kohë pandemie KDI-ja ka ndihmuar punëtorin e një institucioni publik, pasi që menaxhmenti e kishte nxjerrë para komisionit disiplinor për shkelje të rëndë të punës përkatësisht refuzimin e punës. Bashkë me punëtorin, KDI-ja ka ndihmuar në shkrimin e ankesës dhe përgatitjen e mbrojtjes së punëtorit përballë komisionit disiplinor. Pas ankesës së dorëzuar dhe provave të paraqitura në lidhje me punën e realizuar nga punëtori, komisioni disiplinor ka anuluar kërkesën e menaxhmentit për shqiptimin e masave ligjore kundër punëtorit.

KDI-ja pret nga bizneset dhe Qeveria që të fokusohen sa më shumë në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në këtë kohë pandemie, kjo pasi që mbrojtja e punëtorëve është mbrojtje edhe e bizneseve.

¹⁴ Inspektorati i Punës është duke funksionuar normalisht gjatë kohës së pandemisë në shtatë qendrat e tij (Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Ferizaj, Prizren, Gjiilan dhe Gjakovë). Në kontaktin e KDI përmes telefonit (datë 28.04.2020) me Inspektoratin e Punës, kupton që numri i ankesave të punëtorëve në IP është më i madh dhe menjëherë trajtohen nga inspektorët në të gjitha qendrat në tërë territorin.



Rekomandimet

KDI-ja edhe në këtë rast ka disa rekomandime për institucionet e Kosovës, përkatësisht Qeverinë, Inspektoratin e Punës, Administratën Tatimore:

- 1** Qeveria e Kosovë ta rrisë numrin e inspektorëve të punës në Inspektoratin e Punës në tërë territorin;
- 2** Të intensifikohet bashkëpunimi në mes të Administratës Tatimore të Kosovës dhe Inspektoratit të Punës për lehtësimin e procedurave të raportimit të shkeljeve nga punëtorët gjatë pandemisë;
- 3** Inspektorati i Punës të fillojë sa më parë fushatën vetëdijësuese për punëtorët e sektorit privat dhe bizneset për t'i informuar ata mbi të drejtat e tyre që burojnë nga marrëdhënia mbi mbrojtjen e shëndetit në punë, veçanërisht tash në kohë pandemie;
- 4** Administrata Tatimore e Kosovës dhe Inspektorati i Punës të ju ofrojnë punëtorëve që të raportojnë rastet në mënyrë anonime për shkeljet të kontratës, mos pagesë të kontributeve, rrezikim i shëndetit në punë etj;
- 5** Punëtorët të cilët paguhen me para të gatshme duhet të kërkojnë nga biznesi ku punojnë kontratat e rregullta të punës, sipas kërkesave që dalin nga pakoja emergjente e Qeverisë;
- 6** Punëtorët të cilët paguhen me para të gatshme në rast se ju refuzohet kërkesa për nënshkrimin e kontratës së rregullt nga punëdhënësi, atëherë duhet ta raportojnë punëdhënësin në Inspektoratin e Punës dhe Administratën Tatimore.
- 7** Punëtorët të cilët paguhen me para të gatshme pas refuzimit nga punëdhënësi për kontratë të rregullt, duhet të regjistrohen në Entin për Punësim si të papunë.



Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) / Transparency International Kosova (TIK), beson në një Kosovë ku qeveria, bizneset, shoqëria civile dhe jeta e përditshme e qytetarëve janë të lira nga korrupsioni. KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike. Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare nga Ministria Federale e Punëve të Jashtme e Gjermanisë



Numri pa pagesë 0800 77777 përkrahet nga Ipko dhe Vala:

